



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 068 20 80770
E-mail: bleskaj@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 20/12/2018

V E N D I M

Nr. 229, Datë 20.12.2018

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS "CILESIA DHE
TARIFIMI I SHERBIMEVE STUDENTORE PRANE IAL-VE PUBLIKE"**

Në zbatim të planit vjetor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAL etj.), sipas programit të auditimit nr. 750/7 prot., datë 18.10.2018, realizoi auditimin me temë "Cilësia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike". Subjekt i këtij auditimi ishin:

1. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
2. Universiteti i Tiranës.
3. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
4. Universiteti Bujqësor, Tiranë.
5. Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër.
6. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.
7. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
8. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë.

Faza e terrenit të auditimit nisi në dt. 24.09.2018 me programin e auditimit të cituar më lart dhe përfundoi më datë 16.11.2018.

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi auditues priti observacionet nga subjektet nën auditim. Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër përcolli brenda afatit ligjor me shkresën Nr.3255/4 Prot., datë 27.11.2018; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë me shkresën nr. 1500/8 Prot., datë 14.12.2018 dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë me shkresën nr. 1420/2 Prot., datë 18.12.2018. Subjektet e tjera, nuk përcollën observacione, duke pranuar në heshtje projekt-raportin auditues.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi auditues i Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standarteve dhe Kontrollit të Cilesisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja "c" të

Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit":

KONKLUDOVA:

Arsimi i lartë në Shqipëri është një e mirë publike dhe si i tillë, shteti dhe gjithë shoqëria duhet t'i kushtojë një vëmendje të posaçme. Reforma e ndërmarrë në fushën e arsimit të lartë duhet ti shërbej krijimit të një arsimit të lartë cilësor, që të mund ti përgjigjet nevojave të tregut të punës, si dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit, nëpërmjet krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm të brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit, për të siguruar standarde europiane në sistemin e arsimit të lartë. Mbetet imediate konsolidimi i autonomisë akademike dhe financiare të IAL-ve publike. Përpos kësaj IAL-të duhet të ofrojnë shërbime më cilësore për studentët duke i përmirësuar ato ekzistuese dhe njëkohësisht duhet të rrisin shërbimet onLine, duke garantuar cilësi dhe standarde konkurruese me vendet e zhvilluara europiane.

Sipas parashikimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë¹, IAL-të publike vendosin tarifën e shkollimit duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave² dhe më pas janë bordet e administrimit të IAL-ve publike që miratojnë tarifën e shkollimit dhe shërbimeve për studentët mbas vendimeve të marra nga senatet akademike të tyre. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton kufirin maksimal të tarifës së shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe ato të ciklit të dytë të integruar në institucionet publike të arsimit të lartë, bazuar në propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Ndërkohë tarifën për ciklin e dytë, të tretë dhe program të dytë studimi nuk kanë kufizim me Vendim të Këshillit të Ministrave, por janë vetë IAL-të publike që i vendosin me vendim të bordeve të administrimit.

Të ardhurat që përfitohen nga tarifën e shkollimit, regjistrimit, konkurrimit dhe të shërbimeve të tjera studentore përbëjnë një të ardhur të rëndësishme për procesin mësimor, akademik, shkencor dhe administrativ të IAL-ve publike.

Të ardhurat dytësore në IAL-të publike, përfitohen kryesisht nga tarifën e shkollimit dhe të shërbimeve ndaj studentëve, të cilat variojnë në diapazonin 27-51% kundrejt buxhetit total³ të IAL-ve subjekt i këtij auditimi.

Gjatë këtij auditimit u evidentuan disa problematika ku më kryesoret janë:

- a) Shërbimet ndaj studentëve janë të limituara dhe me shumë hallka burokratike;
- b) Mungesa e indikatorëve të matjes së performancës së shërbimeve ndaj studentëve;
- c) Cilësia e ulët e shërbimeve të ofruara pranë IAL-ve publike ndaj studentëve;
- d) Tarifën e shkollimit janë të vendosura jo mbi bazën e analizës së kostove dhe kushteve social ekonomike të vendit; etj.

Ndër shqetësimet kryesore të studentëve të IAL-ve publike është cilësia e ulët e shërbimeve dhe tarifën e larta të shkollimit, të shërbimeve si dhe mungesa e kartës së studentit. Njëkohësisht mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore nga ministria përgjegjëse për arsimin si dhe nevoja për të zhvilluar një kulturë të orientuar drejt cilësisë së shërbimeve në IAL-të publike nënvizoi domosdoshmërinë e vlerësimit të burimeve dhe mekanizmave të përdorur, për realizimin e objektivave të institucioneve

¹ Neni 7 pika "f" e Ligjit 80/2015 mbi Arsimin e Lartë

² VKM Nr.288, date 21.05.18...përcaktimi i kufirit maksimal të studimit në IAL-të publike

³ Buxheti total IAL-ve përbehet nga Fondi I MASR dhe të ardhurat dytësore të krijuara nga vetë IAL-të

të arsimit të lartë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve si dhe përcaktimin e tarifave mbi bazën e analizës së kostove dhe marrjen parasysh të kushteve social ekonomike të vendit.

Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga IAL-të publike dhe vlerësimi i tarifave mbi bazën e një analize kostoje për çdo program studimi, mbetet një domosdoshmëri imediate për të ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shërbimeve ndaj studentit.

Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve dhe kostimi i tyre do të shërbejnë në përcaktimin në mënyrë të drejt dhe eficient të tarifave të shkollimit, shërbimeve të ofruara, kuotave të pranimit në programet e studimit pranë IAL-ve publike, etj.

Auditimi u përshkrua nga qasja se: *“Financimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe produktet e këtij financimi vijnë të mbeten çështje të parregulluara, kaotike, pa një model të qartë zhvillimi dhe larg realitetit evropian ku aspirojmë të shkojmë.”*

Për sa me lart, pas auditimit, trajtimit të observacioneve, KLSH i qëndron mesazhit auditues se:

Ligji i ri i arsimit të lartë, i konceptuar me kujdes për t’iu dhënë autonominë e nevojshme IAL- publike dhe rivitalizuar rolin e këtyre IAL-ve në kërkim shkencor e arsim bashkëkohor, nuk është implementuar siç duhet nga të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e arsimit të lartë.

MASR vijon të veprojë kundra këtij Ligji, përmes centralizimit të panevojshëm që i bën nga njëra anë me akte të panevojshme nënligjore funksioneve që në fakt Ligji ua njeh IAL-ve dhe nga ana tjetër, duke mos bërë funksionale strukturat përkatëse për financimin dhe rregullimin e arsimit të lartë. Anëtarët përfaqësues të kësaj ministrie në bordet e administrimit të IAL-ve publike, ku përfaqësojnë shumicën vendim-marrëse, nuk i kanë kryer me përgjegjshmëri detyrat e tyre, duke mos garantuar qëndrueshmërinë financiare autonome të këtyre institucioneve, madje duke marrë vendime financiare pa analiza kostoje për tarifimin e shërbimeve që ofrojnë.

IAL-të vijnë të mbeten pasive në marrjen përsipër të përgjegjësisë për të ofruar një arsim cilësor ndaj studentëve të tyre, kërkim shkencor real (jofiktiv dhe aplikativ) dhe tarifa konkurruese për të financuar me kosto optimale shërbimet e tyre. Mendësia e drejtuesve të IAL-ve publike nuk është ende përshtatur me vizionin dhe kompetencat e Ligjit të Ri të Arsimit të lartë, ndërsa mendësia e pedagogëve vijon të jetë më afër asaj të mësuesit sesa kërkuesit shkencor.

Nën perceptimin e studentëve, IAL-të kujdesen pak ose aspak për cilësinë e shërbimeve që ofrojnë tek ta.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve në këtë sektor:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Cilësia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike”;

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Për pyetjen: **A financohen njësitë bazë të IAL-ve publike për kërkimin shkencor nga fondi i të ardhurave të veta?**

Fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

- a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) granti i mësimdhënies;
- c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

Këshilli i Ministrave miraton me vendim modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Zbatimi i skemës së financimit, sipas këtij ligji, për institucionet publike të arsimit të lartë, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të përgjegjës së financave dhe të arsimit.

Një burim i rëndësishëm financimi për veprimtarinë e IAL-ve publike janë dhe të ardhurat e përfituara nga tarifat e shkollimit dhe shërbimeve të ndryshme ndaj studenteve.

Sipas përcaktimeve të LAL⁴ dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave⁵ agjencia që do të financoj IAL-te publike është parashikuar të jetë AKFAL⁶. Kjo strukturë⁷ nuk është ngritur ende dhe kompetencat e saj i ushtron MASR-ja duke financuar IAL publike sipas modelit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Pra për sa më lart IAL-të publike bëjnë planifikimin e Buxhetit nëpërmjet PBA-ve⁸ të cilat pasi miratohen në Bordet e Administrimit i përcillen MASR-së.

Gjatë konsultimit me evidencën dokumentare që disponon grupi auditues si gjatë fazës studimore dhe asaj analitike evidentoi diferencë midis fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit dhe kërkesave buxhetore⁹ për mësimdhënien e IAL-ve publike.

Për ta sqaruar këtë fakt, iu drejtuam IAL-ve publike me pyetjen:

A kanë planifikuar për vitin 2017/18 njësitë kryesore në PBA-të respektive kërkesa buxhetore për garantimin e procesit të mësimdhënies sipas përcaktimeve të akteve nënligjore?

Në mënyrë të përmbledhur të gjitha IAL publike subjekt i këtij auditimi pohuan që i kanë hartuar PBA-të sipas modelit dhe skemës së financimit të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Në përgjigjet zyrtare të tyre, të gjitha subjektet e këtij auditimi janë financuar më pak se planifikimi i tyre. Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës¹⁰ për vitin buxhetor 2018 kishte planifikuar 969,961,000 lekë dhe iu alokuan 508,824,000 lekë, pra 52% të planifikimit; Universiteti i Tiranës është financuar me 58% të planifikimit; Universiteti Bujqësor i Tiranës është financuar me 91% të planifikimit; Universiteti i Mjeksisë, Tiranë është financuar me 81% të planifikimit; Universiteti “Luigj Gurakuqi”

⁴ nenit 110 i LAL 80/2015

⁵ VKM 397 date 03.05.2017 dhe nr. 75, datë 12.02.2018

⁶ Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë

⁷ VKM nr.75 date 12.02.2018, kapitulli V-Dispozitat e fundit pika 3 (tre)

⁸ Projekt Buxheti Afat mesem

⁹ Nepermjet PBA

¹⁰ Shkresa nr. 1635/1 Prot. Date 30.10.2018

Shkodër është financuar me 76% të planifikimit; Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë është financuar me 89% e planifikimit; Universiteti “ Fan S. Noli” Korçë është financuar me 98% të planifikimit.

TARIFAT E SHKOLLIMIT DHE SHËRBIMEVE STUDENTORE

IAL-të publike bazuar në Ligjit e Arsimin e Lartë¹¹, vendosin tarifën e shkollimit për ciklin e parë dhe atë të studimeve të integruara të ciklit të dytë duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave¹². Të ardhurat që përfitohen nga tarifën e shkollimit, regjistrimit, konkurrimit dhe të shërbimeve të tjera ndaj studentit përbëjnë një të ardhur të rëndësishme për procesin mësimor, akademik, shkencor dhe administrativ të IAL-ve publike.

Bazuar në të dhënat e IAL-ve publike subjekt i këtij auditimi, të ardhurat dytësore të përfituara kryesisht nga tarifën e shkollimit dhe të shërbimeve ndaj studentëve, variojnë nga 27-51% kundrejt buxhetit total¹³.

Studenti gjatë procesit të pranimit në IAL-të publike paguan:

- Tarifë aplikimi për program studimi pranë QSHA;
- Tarifë për konkurs vetëm për disa IAL publike;
- Tarifë regjistrimi pranë IAL-së; (kjo tarifë paguhet vetëm në vitin e parë të studimeve)
- Tarifë shkollimi pranë IAL-së.

Më pas në IAL-të publike, studentët paguajnë tarifën si më poshtë¹⁴:

- Tarifa për Master Profesional;
- Tarifa për Master Shkencor;
- Tarifa për Doktoraturë / Specializim;
- Tarifa për Programin të dytë Studimi;

Dhe tarifa shërbimi, si:

- a) Tarifa për Diplomën;
- b) Tarifa për Vërtetim Studenti;
- c) ... etj.

Perceptimi i studentëve dhe i aktorëve të tjerë të shoqërisë shqiptare është që tarifën e studimit në IAL-të publike janë të larta. Për të vlerësuar nëse vërtet janë të larta apo jo, duhet që pikësëpari të llogariten kostot e programit të studimit dhe shërbimeve për të bërë më pas krahasimin me tarifën e vendosura nga IAL-të ndaj studentit.

Në vijim të pyetjes së shtruar nga grupi auditues:

A janë përcaktuar tarifën për shkollim dhe shërbime mbi bazën e një analize kostoje?

Të gjitha IAL-të pohuan që nuk kanë bërë analizë të kostove të tarifave sipas programeve të studimit për student për ciklin e studimeve bachelor dhe atë të ciklit të dytë të integruar¹⁵.

Sipas grupit auditues, përgjithësisht të gjitha IAL-të publike subjekte të këtij auditimi, nuk kanë përdorur metodologjinë të saktë për përcaktimin e kostove të studentëve sipas

¹¹ Neni 7 pika “f” e Ligjit 80/2015 mbi Arsimin e Lartë

¹² VKM Nr.288, date 21.05.18...përcaktimi i kufirit maksimal të studimit në IAL-të publike

¹³ Buxheti total IAL-ve perbehet nga Fondi I MASR dhe te ardhurat dytesore te krijuara nga vete IAL -të

¹⁴ Masa e të cilave vendoset nga Bordet e Administrimit

¹⁵ Sipas shkresë se UMT me nr.1500/6 date 31.10.2018 fq. 18 pika a

programeve të studimit. Tarifatat janë vendosur pothuajse të njëjta me tarifatat e 3-4 viteve e fundit duke respektuar Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Bazuar në përgjigjet zyrtare të subjekteve asnjë prej tyre nuk ka paraqitur relacion të analizës së kostos së studentit sipas programit të studimit dhe mbi bazën e analizës së shpenzimeve të përcaktonin tarifatat për program studimi.

N.q.s. për ciklin e parë dhe atë të integruar të ciklit të dytë të studimeve, LAL parashikon vendosjen e kufirit tavan për tarifatat e shkollimit, ndërsa për tarifatat e studimit *për ciklin e dytë, ciklin e tretë dhe program të dytë studimi, LAL dhe aktet nenligjore nuk parashikojë një kufizim të tillë*. Pasi në kuadër të autonomisë financiare këtë atribut ligji ia njeh IAL-ve publike nëpërmjet përcaktimit të tyre nga senate akademike dhe bordet e administrimit.

Në vijim për sa më lartë, tarifatat e studimit për “Master i shkencave” dhe “ Master profesional” sipas modelit “çmim për kreditë” është i njëjtë me tarifatat e mëparshme të këtyre cikleve të studimit dhe para hyrjes në fuqi të LAL 80/2015. Këto tarifa propozohen nga senati akademik dhe miratohen nga bordi i administrimit.

Pra në ndryshim me tarifatat e ciklit të parë (bachelor); Tarifatat ciklit të dytë të studimeve nuk ka kufizim me me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Bazuar në përgjigjet zyrtare të IAL-ve konstatohet që përcaktimi i tarifave për ciklin e dytë (Master), ciklin e tretë dhe program të dytë studimi nga senatet akademike dhe me pas miratimi nga bordet e administrimit nuk janë shoqëruar me relacione të analizës së kostove, por janë mjaftuar duke ruajtur vlerat e njëjta me tarifatat respektive para miratimit të LAL¹⁶.

STRUKTURAT ORGANIZATIVE TË IAL-ve PUBLIKE

Bazuar në të dhënat e IAL-ve publike dallohet lehtë që strukturat organizative janë të fryra si rrjedhim ato kanë rritur shpenzimet mbi të ardhurat. Bazuar në të dhëna mbi numrin e personelit akademik; ndihmës akademik; administrativ, etj., të cilat shërbejnë si indikator të performancës për menaxhimin e shpenzimeve të IAL-ve publike, vërehet që raporti i nr. personelit (administrativ dhe mbështetës) kundrejt stafit akademik është i lartë, p.sh., Universiteti Tiranës, e ka raportin 0.47; Universiteti Bujqësor i Tiranës; 0.85; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, 0.40; Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, 0.61; Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, 0.46; Universiteti “Isamil Qemali” Vlorë, 0.49; Universiteti “F.S. Noli”, Korçë, 0.51

Një tregues tjetër i rëndësishëm është dhe raporti i shpenzimeve për personelin ndaj të ardhurave, të pasqyruara më poshtë

- Universiteti i Tiranës shpenzon 25% e të ardhurave për pagesat e personelit.
- Universiteti i Durrësit shpenzon 41% e të ardhurave për pagesat e personelit.
- Universiteti i Vlorës shpenzon 27% e të ardhurave për pagesën e personelit.

AUDITIMI I BRENDSEM INSTITUCIONAL

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre realizohen nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit. Krijimi dhe funksionimi i njësiteve të auditimit të brendshëm bëhen në përputhje me aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.

¹⁶ LAL 80/2015 është miratuar në Tetor 2015

Nga evidenca dokumentare¹⁷ rezulton që *Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës* ka të miratuar në strukturën organizative; Drejtorin e Auditit të Brendshëm me 1(një) Drejtor dhe 2(dy) specialist. Aktualisht kjo drejtori ka vetëm Drejtorin pasi vendet e 2 (dy) specialisteve janë ende të paplotësuar.

Struktura e Njësisë së auditimit të brendshëm në UAMD është në kundërshtim me VKM nr. 83 datë 3.2.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik", ku çdo njësi publike që plotëson kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave duhet të ngrejë njësinë e auditimit të brendshëm e cila duhet të përbehet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë.

FINANCIMI I KERKIMIT SHKENCOR NGA TE ARDHURAT

Në vijim, grupi auditues në lidhje me financimin e kërkimit shkencor nga të ardhurat, shtroj pyetjen; *Nëse IAL-te publike kishin parashikuar fonde për vitin 2017/18 për njësite kryesore/bazë për realizimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor¹⁸ nga fondi i të ardhurave të veta.*

Nga përgjigjet e IAL-ve publike përgjithësisht parashikohen fonde nga të ardhurat dytësore për projekte në fushën e kërkimit shkencor përveç; *Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë të cilët nuk kanë parashikuar fond nga të ardhurat për njësitë kryesore/bazë të tyre.*

Sipas grupit të auditimit, vlerësimi i projekteve bëhet përgjithësisht nga këshilli shkencor në institucion dhe njësitë e kërkimit shkencor në njësitë kryesore.

Më pas realizimi i këtyre projekteve monitorohet¹⁹ duke mbajtur dhe të dhëna në bazën e të dhënave të kërkimit shkencor duke mundësuar monitorim e veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik.

Bazuar në përgjigjet e IAL-ve; *Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë nuk ka njësi të vlerësimit dhe monitorimit të projekteve.*

Grupi auditues, për ta ilustrua planifikimin e ulët të fondeve për kërkim shkencor nga të ardhurat e vet IAL-ve publike; në vijim ka paraqitur të dhënat e Universitetit Fan S. Noli²⁰ për vitin 2018 i cili ka planifikuar 4 milion lekë për kërkimin shkencor për vitin 2018. Pra rreth 3.1 % e të ardhurave shkojnë për kërkimin shkencor në Universitetin Fan. S. Noli Korçë.

Ndërsa Universiteti i Mjekësisë, Tiranë²¹ për vitin 2017/18 nuk kishte planifikuar fonde për kërkimin shkencor nga të ardhurat e veta, duke e argumentuar me arsyen që kanë marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Por nga kryqëzimi i të dhënave të AKKSHI-t për vitin 2017 asnjë nga IAL-të subjekt i këtij auditimi nuk kanë aplikuar për projekte kombëtare pranë saj.

Gjetje:

Për sa më lart,

¹⁷ Vendim i Bordit të Administrimit nr.30 date 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithëshme të UAMD"

¹⁸ LAL 80/2015 neni 25 pika 10.

¹⁹ Shkresa nr. 1635/1 prot. Date 30.10.2018. Ky paragraph është marrë nga përgjigjet e UAMD për pyetjen: A monitorohen realizimi i projekteve të financuar nga të ardhurat dytësore.

²⁰ Shkresa nr. 2083 prot. Date 01.11.2018 Përgjigjet zyrtare për intervistën me objekt "Cilesia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike"-Universiteti FAN S. NOLI

²¹ Shkresa nr. 1500/6 prot. Date 31.10.2018 faqe nr.8 pika 2 paragrafi 1 dhe 2

1. Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sportit nuk ka propozuar strukturën dhe organikën për AKFAL-in pranë Këshillit të Ministrave
2. Funksionet e AKFAL-it i ushtron Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sportit
3. IAL-të publike financohen më pak se kërkesa e tyre nga granti i Buxheti të Shtetit për mësimdhënie.
4. Tarifat e shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe atë të integruar të ciklit të dytë të studimeve nuk janë vendosur mbi bazën e analizës së kostove apo të metodologjive të sakta për llogaritjen e tyre.
5. IAL-të publike mbajnë të njëjtën vlerë ose më të vogël me tavanin e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për tarifën e shkollimit për ciklin e parë dhe atë të integruar të ciklit të dytë të studimeve.
6. Tarifat e shërbimeve studentore janë miratuar nga bordet e administrimit jo mbi bazën e analizës së kostove.
7. IAL-të publike vazhdojnë në mënyrë tradicionale të tarifojnë studentët e vetë për marrjen e vërtetimit të studentit.
8. LAL nuk parashikon vendosjen e kufirit tavan, për tarifën e studimit për ciklin e dytë, ciklin e tretë dhe program të dytë studimi. Në kuadër të autonomisë financiare këtë atribut e kanë senatet akademike dhe bordet e administrimit të IAL-ve publike.
9. Tarifat e studimeve për “master i shkencave”, “master profesional”, cikël të tretë studimesh dhe program të dytë studimesh janë vendosur nga IAL-të publike, jo mbi bazën e një analize kostoje.
10. Strukturat organizative të IAL-ve publike janë të fryra me punonjës administrativ dhe mbështetës.
11. Një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave nga tarifën e studenteve shkon për shpenzime pagese për personelin jo akademik.
12. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës nuk ka plotësuar strukturën e njësisë së auditit të brendshëm sipas përcaktimeve ligjore.
13. IAL publike planifikojnë nuk planifikojnë shpenzim nga të ardhurat për kërkimin shkencor në nivel fakulteti/departamenti ose planifikojnë në vlera shumë të vogla.
14. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë nuk ka planifikuar fond për kërkimin shkencor në nivel njësie kryesore/bazë për vitin akademik 2017/18
15. UMT, UBT dhe UIQV nuk kanë përgatitur raportin vjetor për vitin 2017/18.

Konkluzion:

Për sa më lart,

1. Nuk ka gjendur ende zbatim vkm nr. 397 datë 03.05.2017 për ngritjen dhe funksionimin e AKFAL-it.
2. Në zbatim të nenit 110 të LAL dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 është përcaktuar modeli i financimit të IAL-ve; Sipas parashikimeve të VKM²²-së në mungesë të funksionimit të AKFAL kompetencat e saj i ushtron MASR-ja.
3. Nuk ka gjetur zbatim skema e financimit e përcaktuar në VKM nr. 75. Financimi i IAL publike nga Buxheti i Shtetit është më i ulët se kërkesa e planifikuar sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave për IAL-të publike.

²² VKM nr.75 date 12.02.2018, kapitulli V-Dispozitat e fundit pika 3 (tre)

4. Mungon analiza e kostove për përcaktimin e tarifave të shkollimit për të treja nivelet e studimit në IAL-të publike.
5. Njësia e Auditit të Brendshëm në UAMD duhet të plotësohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 83 datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”
6. IAL-të publike duhet planifikojnë buxhet për kërkimin shkencor në nivel njësie kryesore/bazë nga fondi i të ardhurave të veta për çdo vit akademik.
7. UMT, UBT dhe UIQV nuk kanë përgatitur raportin vjetor të vitit 2017/18 kërkesë e parashikuar në nenin 32 të LAL dhe udhëzimit nr. 5 datë 19.02.2018 të ministrit përgjegjës për arsimin; ku përcaktohet që: IAL-të duhet të paraqesin pranë MASR-së për çdo vit akademik raportin vjetorë për veprimtarin e kërkimit shkencor dhe financiar
8. IAL-të subjekt në auditim duhet të bëjnë analizën e kostove për çdo program studimit mbi bazën e të cilës të përcaktohet tarifa për student.

Rekomandim:

Për sa më lart, grupi i auditimit rekomandon:

1. Ministri përgjegjës për arsimin, në zbatim të VKM-së nr. 397 datë 03.05.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë; të propozoj strukturën dhe organikën për funksionimin e AKFAL-it.

Brenda tremujorit të parë 2019

2. Ministra e Arsimit Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të miratojnë udhëzimin e përbashkët “Për skemën e financimit të IAL-ve publike” sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të IAL publike dhe kërkimit shkencor”

Sa më shpejt

3. Administratori i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës të shpall njoftimin për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për specialist të Auditit të Brendshëm sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83 datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”

Sa më shpejt

4. Administratori i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës të kërkojë nëpërmjet Bordit të Administrimit ndryshimin e strukturës së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për të kaluar në nivel sektori, sipas përcaktimeve të VKM 474 pika 21 date 16.06.2011 “ Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike” dhe VKM nr. 83 datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Sa më shpejt

5. Përgjegjësat e njësive bazë në fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë duhet të planifikojnë fonde për kërkimin shkencor në zbatim të LAL 80/2015 neni 25 pika 10 nga të ardhurat e vetë institucionit.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

6. Përgjegjësat e njësive bazë në fakultetet e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë duhet të planifikojnë fonde për kërkimin shkencor në zbatim të LAL 80/2015 neni 25 pika 10.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

7. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë duhet të ngrejë njësinë e vlerësimit dhe monitorimit të projekteve për kërkim shkencor që financohen nga të ardhurat e veta.

Sa më shpejt

8. Universiteti i Tiranës; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Universiteti Bujqësor i Tiranës; Universiteti “Fan S. Noli” Korçë; Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës; Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër duhet të përcaktojnë tarifat e shkollimit dhe shërbimeve ndaj studentëve për të gjitha ciklet e studimit mbi bazën e analizës së kostove të tyre.

Në vijim dhe vazhdimisht

Për pyetjen: **Sa është kontributi i përfshirjes në kërkimin shkencor i stafëve akademike dhe studentëve në IAL-të publike?**

Orientimi i IAL-ve drejt kërkimit shkencor, është një nga padigmat kryesore të universiteteve moderne dhe kompetitive në tregun e punës. Në zbatim të këtij objektiv, çdo anëtar i personelit akademik duhet të jetë i orientuar, në mënyrë të balancuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor.

Instrumentet e monitorimit të impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore janë:

- Performanca e mësimdhënies; si vlerësim tërësor, duke përfshirë edhe angazhimin në kërkimin shkencor dhe reflektimin në cilësinë e mësimdhënies.
- Vlerësimi i teksteve bazë dhe literaturës së përdorur.
- Monitorimi në kohë reale, përmes bazës së të dhënave të kërkimit shkencor etj.

Orientimi i IAL drejt kërkimit shkencor përbën thelbin e ligjit të arsimit të lartë, ku veprimtaria e kërkimit shkencor duhet të shërbejë si indikator i vlerësimit institucional, rankimit dhe financimit; për të shndërruar IAL-të në qendra të vërteta të kërkimit shkencor. IAL-të publike duhet të përcaktojnë prioritetet e kërkimit shkencor nga departamenti/qendra ku të jenë përcaktuar objektivat e veprimtarisë kërkimore të çdo anëtari të stafit akademik.

Një ndër prioritetet e kërkimit shkencor në arsimin e lartë është dhe përfshirja e studentëve në këtë kërkim.

GRANTI I PUNËS KERKIMORE-SHKENCORE

Fondi për kërkim shkencor është i hapur për të gjitha IAL-të që zhvillojnë kërkim shkencor. Në tabelën nr.1 pasqyrohet granti për kërkim shkencor për vitin 2017 dhe 2018. Shpërndarjen e fondeve për kërkim shkencor realizohet nga AKKSHI mbi bazën e projekteve që IAL-të konkurrojnë/aplikojnë pranë saj.

Tabela nr. 1. Granti për kërkimin shkencor për IAL-të publike 2017 dhe 2018
(Në milionë lekë)

Emri i programit	Buxheti për vitin 2017 ²³	Buxheti për vitin 2018 ²⁴
Kërkimi shkencor	365.8	480

Burimi: Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise

Sipas përgjigjeve të IAL-ve publike gjatë vitit 2018 kanë aplikuar në programin kombëtar pranë AKKSHI-t, p.sh. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka aplikuar me projektin²⁵ “Përcaktimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi burimin e emetimeve të grimcave aerosole, mbi territorin e Shqipërisë” si pjesë e programit kombëtar për kërkim dhe zhvillim (PKKZH) me objekt “Biodiversiteti dhe mjedisi” Më poshtë në tabelën nr. 2 jepen të dhëna mbi produktet e kërkimit shkencor për IAL-të publike gjatë vitit 2017-2018.

Tabela nr.2 Botime dhe pjesëmarrje në konferenca viti 2017-2018

Nr.	Aktiviteti	UBT	UMT	UAMD	ULGSH	UIQV	UFSNK
1	Botime ne revista shkencore brenda vendit	76	132	90	82	96	106
2	Botime ne revista shkencore jashtë vendit	183	117	93	31	237	77
3	Botime ne revista shkencore me faktor impakti	51	91	78	23	90	6
4	Botime ne revista shkencore me pjesëmarrje te studenteve	33	36	1	64	16	0
5	Referime ne Konferenca/seminar shkencore brenda vendit	128	493	287	178	260	76
6	Referime ne Konferenca shkencore/seminar jashtë vendit	144	245	572	90	271	51
7	Referime ne Konferenca/seminar shkencore ku janë përfshirë studentët	29	104	289	97	40	33
8	Pjesëmarrje ne projekte kombëtare	18	33	129	4	17	14
9	Pjesëmarrje ne projekte ndërkombëtare	56	43	71	15	57	32
10	Pjesëmarrje ne borde drejtues te revistave shkencore	32	66	84	29	63	8
11	Botime librash	21	22	79	13	25	12
12	Botime monografi	11	2	20	7	5	1
13	Student ne programe te ndryshme (erasmus; erasmus + etj...)	86	5	6	31	34	2

Burimi: IAL-të publike

Sipas përgjigjeve zyrtare të UT të dërguara me e-mail²⁶ për intervistën e grupit auditues²⁷ për seksionin “Produktet e Kërkimit Shkencor” të dhënat ishin të paplota. UT argumentoj mungesën e të dhënave, të lidhur me kohën e pamjaftueshme të vënë në dispozicion. Si rezultat, në tabelën nr.2 nuk janë pasqyruar të dhënat për produktet e kërkimit shkencor të UT, pasi Institucioni nuk i vendosi në dispozicion të grupit auditues. Mungesa e tyre, kishte të bënte me të dhënat e produktit të kërkimit shkencor pranë fakulteteve të UT-së.

²³ Ligjin nr. 130/2016 datë 17.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”

²⁴ Ligjin nr. 109/2017 datë 18.12.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”

²⁵ Shkresa nr. 2703 prot. Date 10.09.2018.

²⁶ datë 15.11.2018

²⁷ Shkresa me nr.5063 Prot. Date 07.11.2018 (Protokolli i UT)

Mos përcillja e këtyre të dhënave, tregon mungesën e komunikimit efektiv të Institucionit me njësitë kryesore ku këto të fundit i posedojnë ato.

PROGRAMET KOMBETARE TE KERKIMIT SHKENCOR

Gjatë vitit 2017 janë financuar 7 (shtatë) projekte ku 4 (katër) i përkasin UT dhe 3 (tre) Universitetit Bujqësor të Tiranës në vlerë totale 2 873 818 lekë dhe për vitin 2018 janë 5 (pesë) projekte ku 4 (katër) i përkasin përsëri UT dhe 1 (një) universitetit Bujqësor të Tiranës në vlerë totale 1 579 025 lekë, të pasqyruar më poshtë, pasi me mbylljen e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë e Inovacionit – AKTI dhe kalimin në Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit – AKKSHI mundi të financonte projekte e propozuara në vitet 2015-2016 gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017²⁸ nuk ka patur aplikime në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit nga IAL-të publike subjekt auditimi.

Në vitin 2018 IAL-të subjekt auditimi kanë aplikuar në kuadër të thirrjes për aplikim²⁹ të shpallur nga AKKSHI. Financimi i tyre do të bëhet pasi të miratohen në Bordin e Administrimit të AKKSH-it si projekte fituese.

STAF AKADEMIK ME KOHE TE PLOTE DHE ME KOHE TE PJESEHME

Nga të dhënat e paraqitura në raportet vjetore të IAL-ve, nr. i personelit staf akademik me kohë të pjesshme është i lartë. Sipas të dhënave të raportit vjetor 2017-2018 të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës staf akademik me kohë të plotë janë 296 pedagogë dhe 371 janë pedagogë me kohë të pjesshme. Për realizimin e programit të mësimdhënies pedagogeve efektiv të UAMD iu duhet të përballojnë një mbingarkesë prej afro 70% të normës. Mbingarkesa e stafit aktual efektiv ka çuar në një disbalancë mes ngarkesës për mësimdhënie dhe kërkimit shkencor dhe aktivitete administrative, si përfshirje në komisione të ndryshme, shpërndarje ekspertize etj.

Duke qenë se një nga shtyllat kryesore të auditimit është cilësia e mësimdhënies, në pyetësin e realizuar për studentin në seksionin e pyetjeve të hapura identifikohen pakënaqësi nga studentë në lidhje me pedagogët e jashtëm kryesisht mbi respektimin e orarit apo seriozitetin e zhvillimit të orës së mësimi.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë gjatë vitit akademik 2016-2017 ka realizuar 110,351 orë mësimore; nga këto 95,300 orë janë realizuara nga stafi akademik efektiv dhe 15,051 orë nga pedagogë të jashtëm. UIQV ka 206 pedagoge staf akademik efektiv të cilët realizuan 48,050 orë ngarkesë mësimore dhe 47,250 orë mbingarkesë.

RAPORTIMI VJETOR I IAL-ve PER KERKIMIN SHKENCOR

Bazuar në nenin 32 të LAL dhe udhëzimit nr. 5 datë 19.02.2018 të ministrit përgjegjës për arsimin; IAL-të duhet të paraqesin pranë MASR-së për çdo vit akademik raportin vjetor për veprimtarin e kërkimit shkencor dhe financiar. Nisur nga përgjigjet dhe evidenca dokumentare të UMT, UBT, UIQV rezultojnë që këto IAL nuk kanë përgatitur dhe miratuar në senatin akademik dhe bordin e administrimit raportin vjetor të vitit 2017-2018 sipas përcaktimeve ligjore.

ORIENTIMI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE INTEGRIMI ME PRAKTIKËN

²⁸ Shih tabelën nr. 9

²⁹ Date 06.06.2018

Në pyetësoin për studentët vlerësimi për orientimin ndaj kërkimit shkencor dhe praktikës përbënte një nga pjesët kryesore të tij . Më poshtë po paraqesim rezultatet e këtij pyetësoi për këtë rubrikë .

- a. Zbatimi i një procesi kërkimor në një hulumtim studimor shkencor i cili bën pjesë në programet akademike që universitetet ofrojnë, kërkon një orientim praktik dhe teorik nga stafi akademik. Hapin e parë në një kërkim shkencor e përbën, hyrja në metodikën e punës kërkimore shkencore. Grafiku i përgjigjeve na jep një përshkrim të qartë mbi zbatueshmërinë e këtij hapi të punës kërkimore, ku pjesa më e madhe janë përgjigjur midis, dobët dhe mjaftueshëm (përafërsisht 300). Përgjigjet, shumë dobët dhe mirë renditen pas tyre me një diferencë jo të madhe nga të parat, (përkatesisht 250 dhe 220). Në fund renditen përgjigjet shumë mirë (e cila është 160) dhe nuk e di (më pak se 90). Mësimdhënia e lëndëve me interes të veçantë cilësohet me rëndësi për orientimin që jep mbi një kërkim shkencor. Në grafikun e paraqitur, opinioni i studentëve për orientimin që këto lëndë japin, ka një tendencë të jetë midis mjaftueshëm (310) dhe mirë (rreth 280).
- b. Është e nevojshme të paraqitet një reflektim kritik i studentit mbi përmbajtjen e këtyre lëndëve. Përfitimi i dijeve dhe aftësive që marrin nga këto lëndë rezultojnë të jetë i mjaftueshëm (që ka marrë 310 përgjigje) në pjesën më të madhe të përgjigjeve. Më pas renditen opinione të cilat e vlerësojnë si të mirë (280) efektivitetin e këtyre lëndëve dhe në të njëjtin raport me to janë dhe ata që mendojnë se përfitimi nga këto lëndë ka qenë i dobët (280). Një pjesë e këndvështrimit kritik vjen dhe si pasojë e ndihmës që studentët kanë marrë në nxjerrjen rezultateve të tyre kryesore dhe nga të rejtat që kanë pasur të kërkimi shkencor (pa përjashtuar dhe elementë të tjerë subjektiv apo objektiv të një reflektimi kritik). Rezultatet na tregojnë se, pjesa më e madhe e të anketuarve përgjigjen se kanë pasur, dobët (300) apo mjaftueshëm (280) referenca apo të reja në kërkimin shkencor. Studentët që mendojnë se referencat kanë qenë në nivelin mirë (afërsisht 270) janë pothuajse në balancë me ato që mendojnë mjaftueshëm. Orientimi për kërkimin shkencor dhe integrimi me praktikën ka një rëndësi të veçantë për cilësinë e rezultateve. Në përgjithësi orientimi është i mjaftueshëm.
- c. Literatura e nevojshme, përbën një nga elementët kyç për një student që ndjek programet universitare (dhe jo vetëm). Situata na paraqitet në një gjendje jo të duhur përse i takon rëndësisë që ka, pasi një pjesë e konsiderueshme i qëndrojnë mendimit se literatura ka qenë dobët (310) apo mjaftueshëm (305), e nevojshme për të garantuar një mbarëvajtje mësimore optimale. Aksesin në libra dhe revista akademike është i domosdoshëm për zgjerimin njohurive cilësore. Përgjigja, dobët (330) rezultojnë të jetë më e zgjedhura me një diferencë të madhe nga përgjigjet e tjera. Më pas, si më të zgjedhurat renditen opinionet si, të mjaftueshëm (280) dhe të mirë (230). Aksesin në revista elektronike mund të konsiderohet në nivel jo të dëshirueshëm pasi, në përgjigjet e marra, studentët janë të mendimit se ka qenë i dobët (370) dhe shumë i dobët (rreth 350). Alternativat e tjera kanë një diferencë të theksuar në krahasim me ato më të zgjedhurat.
- d. Një tjetër aspekt i cili vlen të theksohet është dhe disponueshmëria e sallave të studimit, e cila ka rëndësi në ofrimin e kushteve të duhura për studentët. Shohim që niveli i disponueshmërisë ka qenë, në të shumtat e përgjigjeve, i mjaftueshëm (300). Me shumë pak diferencë renditen pas tyre dhe studentët që mendojnë se

kjo disponueshmëri ka qenë e mirë (280) apo dobët (260). Pajisja dhe aksesimi i studentëve në mjetet audio-vizuale ka qenë i dobët (360) ose shumë i dobët (350), referuar përgjigjeve më të përzgjedhura. Në terma të përgjithshme disponueshmëria në biblioteka konsiderohet midis një niveli të mjaftueshëm dhe të dobët në disa raste. Aksesimi në ambientet e bibliotekave duhet të jetë më i lartë duke rritur cilësinë, shërbimet e ofruar duke ndjekur metodat bashkëkohore të funksionimit të kësaj njësie.

- e. Pedagogët në universitetet publike gjatë procesit të mësimit përdorin një diversitet materialesh ku materialet e printuara (53.3%) zënë pjesën më të madhe, gjithashtu përdorin edhe materiale elektronike (48.5%), libra (42%) dhe shumë metoda të tjera. Materialet e përdorura duhet të jenë të kontrolluara nga institucionet përkatëse për përmbajtjen e tyre në mënyrë që mësimdhënia të jetë sa më efikase për studentët.

Gjetje:

Për sa me lart,

1. Niveli i ulët i përfshirjes së studenteve në procesin e kërkimit shkencor pranë IAL-ve publike
2. IAL-të publike nuk kanë paraqitur asnjë projekt për kërkim shkencor në programin kombëtar gjatë vitit 2017 pranë AKKSHI-t.
3. IAL-të publike nuk kanë paraqitur asnjë projekt me bashkëfinancim pranë AKKSHI-t
4. Mungesa e pjesëmarrjes së studenteve në botime dhe revista shkencore në Universitetin e Korçës
5. Rezulton nr. i ulët i botimeve në revista me faktor impakti nga Universiteti i Korçës
6. Rezulton financim i ulët nga të ardhurat për kërkimin shkencor nga Universiteti i Korçës
7. Rezulton nr. i ulët i pjesëmarrjes në konferenca shkencore jashtë vendit nga stafi akademik i Universitetit të Korçës
8. Pranë IAL-ve publike, rezulton mbingarkesë e lartë e stafit akademik efektiv për realizimin e procesit të mësimdhënies.
9. Stafet akademike me kohe të plotë për shkak të mbulimit të një mbingarkese që shkon deri në 70% të normës, janë më të angazhuar me procesin e mësimdhënies se sa me veprimtari direkte të kërkimit shkencor
10. Struktura organizative të IAL-ve janë të pa plotësuara dhe me vende vakante për staf akademik me kohë të plotë.
11. Mungesa e rekrutimeve për plotësimin e pozicioneve vakant me pedagogë efektiv në strukturat e miratuara aktuale të Universitetit të Durrësit.
12. Pranë subjekteve në auditim rezulton numër i lartë i pedagogëve me kohë të pjesshme kundrejt stafit akademik efektiv.
13. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë; nuk kanë hartuar dhe miratuar raportin vjetor për kërkimin shkencor për vitin 2017-2018.
14. Problematika të identifikuar nga studentë mbi cilësinë e mësimdhënies dhe mungesës së orientimit praktik dhe teorik për punë kërkimore shkencore nga stafi

akademik.

15. Problematika të identifikuar nga studentë mbi mungesat e literaturës së nevojshme pranë bibliotekave të institucioneve apo të njësive kryesore.

Konkluzion:

Për sa më lart,

1. Përfshirja e studenteve në veprimtari kërkimore shkencore është e ulët, stafet akademike vazhdojnë në mënyrë tradicionale dhe për shkakë të mbingarkesës së lartë të jenë të fokusuar më shumë tek procesi i mësimdhënies dhe jo nga kërkimi shkencor.
2. IAL-te publike duhet të aplikojnë/konkurrojnë me projekte cilësore dhe impakt në fushën e studimit për të përfituar financim nga AKKSHI.
3. Mungesa e rekrutimeve për plotësimin e pozicioneve vakant me pedagogë efektiv në strukturat e miratuara aktuale ka rritur mbingarkesën e stafeve akademike me kohë të plotë duke krijuar disbalancë mes ngarkesës për mësimdhënie dhe kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative (përfshirje në komisione të ndryshme, shpërndarje ekspertize etj.)

Rekomandim:

Për sa më lart, grupi i auditimit rekomandon:

1. Universiteti Fan S. Noli duhet të përfshijë dhe të promovoj punimet shkencore të studentëve në botimet shkencore të institucionit.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

2. IAL-të publike subjekte të auditimit³⁰ të përfshijnë studentë të ciklit të dytë të studimeve në projekte kërkimore, si pjesë e vlerësimit të tyre vjetor apo në tezat e diplomës.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

3. IAL-të publike subjekte të auditimit të hartojnë plane të veprimit për zbatimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor në IAL-të publike

Në vijimësi dhe vazhdimisht

4. IAL-të publike subjekte të auditimit duhet të përzgjedhin punime të doktoraturës në përputhje me prioritetet e kërkimit shkencor të njësive bazë dhe kërkesave të tregut të punës në përputhje me programin e studimit.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

5. IAL-të publike subjekte të auditimit, të financojnë punimet e doktoraturës nga granti për kërkim shkencor të akorduar nga AKKSHI sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

³⁰ Universiteti i Tiranës; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Universiteti Bujqësor i Tiranës; Universiteti "Fan S. Noli" Korçë; Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës; Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër

6. IAL-të publike subjekte të auditimit duhet të risin financimin dhe mbështetjen për kërkim shkencor nga burimet e veta financiare.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

7. NJSBC-të, pranë IAL-ve publike subjekte të auditimit duhet të vlerësojnë në mënyrë periodike efektivitetin e veprimtarisë kërkimore në njësitë kryesore të tyre, në përputhje me standardet e kërkuara të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

8. Senatet akademike në bashkëpunim me bordet e administrimit të IAL-ve publike subjekte të auditimit të mundësojnë vendosjen e një sistemi "pikëzimi" për vlerësimin e performancës së stafit akademik në punën kërkimore shkencore dhe konvertimin e saj në shpërbllim financiar.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

9. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të hartojnë raportin vjetor për vitin 2017-2018, në zbatim nenin 32 të LAL dhe udhëzimit nr. 5 datë 19.02.2018, të ministrit përgjegjës për arsimin.

Sa më shpejt

Për pyetjen: **A kanë shërbyer sistemet informatike në IAL-të publike në rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve Online ndaj studentit?**

Në përgjithësi të gjitha IAL-të publike përdorin sisteme informatike për menaxhimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik me qëllim përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve ndaj studentëve. Ato janë sisteme të integruara për menaxhimin e të gjithë ciklit të studimit deri në fazën e diplomimit.

Avantazhet e sistemeve informatike:

- Automatizim të shërbimeve administrative dhe mësimore për studentët dhe personelin akademik.
- Gjenerim automatik dhe mundësi për zhvillim raportesh dhe statistikash në nivele të ndryshme raportimi, për personelin akademik, mësimdhënës dhe administrativ.
- Printim i vërtetimeve studentore, listës së notave dhe diplomës me elemente sigurie të lartë.
- Dixhitalizimi i administrimit dhe menaxhimit të kurrikulave të studentëve në të gjitha programet e studimit

Gjatë fazës analitike grupi i auditimit iu drejtua subjekteve në auditim me pyetjen: ***A posedon IAL-ia juaj, Sistem Informatik për automatizimin e proceseve të sekretarive mësimore (proces verbaleve, notave, etj.) dhe shërbimeve online për studentët?***

IAL-të në përgjigjet e tyre zyrtare pohuan që përdorin sisteme informatike për menaxhimin e aktivitetit të mësimdhënies dhe shërbimeve të digjitalizuar për studentët nëpërmjet sekretarisë mësimore elektronike. Vetëm Universiteti i Tiranës, nuk përdor sistemin informatik.

Sistemi informatik për menaxhimin e aktivitetit të mësimdhënies dhe shërbimeve të digjitalizuar për studentët nëpërmjet sekretarisë mësimore elektronike në Universitetin e Tiranës, nuk është funksional që prej vitit 2017³¹.

Në mënyrë të përmbledhur përgjigjet e IAL-ve publike vijnë si më poshtë:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në bashkëpunim me Rrjetin Akademik të Universiteteve Shqiptare (RASH) posedon Sistemin Informatik ESSE3 që përdoret për automatizimin e proceseve të sekretarive mësimore (regjistrimin, procesverbalet, notat, etj.) dhe shërbimeve online për studentët.

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ka implementuar prej vitit 2010 dhe ka në përdorim një sistem të integruar të menaxhimit të të dhënave të studentëve³². Ky sistem mundëson një menaxhim të integruar të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët.

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, në bashkëpunim me Rrjetin Akademik të Universiteteve Shqiptare (RASH) posedon që prej vitit 2013 Sistemin Informatik ESSE3 që përdoret për automatizimin e proceseve të sekretarive mësimore (regjistrimin, procesverbalet, notat, etj.) dhe shërbimeve online për studentët.

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, në bashkëpunim me RASH-in prej vitit 2013 ka implementuar sistemin informatik ESSE3 i cili ofron funksionalitetet e nevojshme tek "backoffice" i administratës, ashtu si dhe përdoruesve fundor (studentëve, pedagogëve, etj), në mënyrë që të menaxhojë të gjithë ciklin e studimeve të studentit: si regjistrimi në silabuset e kurseve, vlerësimet deri në diplomim dhe gjithashtu transferimet nga njëri universitet në tjetrin.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë përdorë sistemin informatik "UVMS" për automatizimin e proceseve dhe shërbimeve online për studentet i zhvilluar nga vetë universiteti.

Universiteti Bujqësor i Tiranës; aktualisht ka të instaluar dhe në funksion të plotë sistemin e informatizuar:

- a) Esse3, sistemi i integruar i shërbimit të sekretarisë mësimore. Përmes këtij sistemi menaxhohet dhe rruhet në rrugë digjitale një volum i konsiderueshëm të dhënash dhe informacioni si:
 - Dokumentacioni i regjistrimit për çdo student (sipas udhëzimeve përkatëse të regjistrimit),
 - Dokumentacioni që lidhet me zhvillimin e procesit mësimor (kurrikulat mësimore, strukturën e vitin akademik etj.),
 - Dokumentacioni që lidhet me rezultatet e vitit si edhe provimet dhe rezultatet e tyre,
 - Dokumentacioni për diplomimin e studentëve,
 - Dokumentacioni që lidhet me përgatitjen dhe shpërndarjen e dokumenteve të studentëve, të diplomave, diplomën suplement, etj.
- b) IRIS, sistemi i integruar i shërbimit për kërkimin shkencor.
- c) UGOV, sistemi i integruar për shërbimin ndaj veprimtarisë financiare dhe regjistrimit të të dhënave.

Në vijim të pyetjes:

³¹ Sipas përgjigjeve të administratorit të UT

³² Sistemin informatik AULA

A iu ofrohet studentëve informacion i përditësuar në faqen e Web-it të Institucionit/fakultetit?

Përgjithësisht të gjitha IAL-të kanë ndërtuar faqe web-i të cilat janë aktive dhe kanë informacion dhe të dhëna për fakultetet e tyre. Në këto faqe kryesisht mungon programi i transparencës³³ ose nuk aksesohen dokumentat e paraqitura në të, pasi mungon link-u. Studentët përgjithësisht informohen mbi veprimtarinë e përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifën, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime etj.

Pothuajse të gjitha IAL publike subjekt auditimi i kanë pajisur studentet me adresa zyrtare e-mail-i nëpërmjet tyre marrin informacion në lidhje me notat, kurrikulat/planet mësimore, regjistrojnë orarin, marrin njoftime që kanë të bëjnë me orarin, aktivitete si dhe pagesat e tarifës së shkollimit etj.

PRAKTIKË E MIRË KOMUNIKIMI:

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër në përpjekje për të rritur cilësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit midis administratës, stafit akademik dhe studenteve prej vitit 2011 sistemin e-mail e ka hostuar në platformën Live@EDU dhe me pas duke e zëvendësuar me platformën Office365.com ofruar nga Microsoft-i pa pagesë si pjesë e domain-it edu.al. (Promovuar nga Microsoft Albania në ULGSH).

Si rezultat i saj *Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër* ka përfituar adresa e-mail pa limit duke pajisur të gjithë studentet pa pagesë

Disa nga veçoritë kryesore nga aksesimi i adresave të e-mail tek mail.office365.com

- Hapësire për mailbox-in (10 GB)
- Hapësire për të ruajtur dokumentet online (*OneDrive 25 GB mundëson magazinimin e skedarëve në një vend, I ndan ato me të tjerët dhe I merr ato nga çdo pajisje e lidhur me internet.*)
- Siguri e lartë komunikimi, mbrojtje nga spam dhe viruse
- Mban kontakte organizon axhendën me People, Planner, To-Do
- Programet si Word, Excel, PowerPoint, OneNote, Outlook dhe programe të tjera të cilat bëjnë të mundur organizimin e planeve të mësimi, krijimin e sondazheve apo kuizeve duke facilituar marrjen e rezultateve , ndërtimi i web apps, mundësi për të ndarë punën dhe bashkëpunimin në grup, etj.

SHERBIMET ONLINE NDAJ STUDENTEVE

Pyetja e shtruar në vijim: *A iu ofrohen shërbime onLine studenteve për kryerjen e pagesave të tarifave të shkollimit/shërbimit?*

Kërkonte të identifikonte a ofrojnë shërbime onLine (paperless) IAL-te publike duke siguruar cilësi dhe njëkohësisht duke zvogëluar kostot e shërbimit, etj.

Për këtë kemi tre tipologji të ofrimit të shërbimeve onLine në IAL-të publike:

1. Pagesat për tarifën e studimit janë të pasqyruara në faqen Web, nga ku studenti mund ti printojë dhe të bëjë pagesën në postë/bankë të tarifës përkatëse të shkollimit apo të shërbimit
2. Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve u mundëson studentëve të bëjnë

³³ sipas parashikimeve të ligjit 119/2014 “ për të drejtën e informimit” neni 7.

download nga adresa e tyre e-mail faturën për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit. Duke bërë pagesën në postë/bankë të tarifës përkatëse të shkollimit apo të shërbimit

3. **Nëpërmjet sistemit informatik ESSE3 çdo student ka llogarinë e tij “user account”** të aksesueshme online në çdo moment në të cilën ai merr informacion përveç programit të studimit, kurrikulave, krediteve të lëndëve, librezës së tij të notave edhe për tarifën e studimit të detajuara të shoqëruara edhe me afatin e skadencës. Kështu studentit i ofrohen informacion në lidhje me:
- Pagesa të ndryshme (tarifë regjistrimi, tarifa shkollimi, librezë, tarifë bibliotekës dixhitale)
 - Gjenerim i faturave dhe vërtetim i pagesave për kategori të ndryshme të studentëve.
 - Raportim për statusin e pagesave të kryera.

KARTA E STUDENTIT

Studentët shqiptar ende nuk kanë një kartë studenti. Sipas parashikimit të LAL, studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë duhet të pajisen me kartën e studentit³⁴, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët do të mundin të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit duhet të përcaktoj kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit duhet të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësisive të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore duhet të bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Sipas përgjigjeve të MASR në lidhje me implementimin e kartës së studentit, nga MASR është ngritur një grup pune, i cili është në komunikim me përfaqësuesit e Bashkimit Europian dhe përfaqësuesë të kartës europiane të të rinjve, për të implementuar një kartë studenti e cila të jetë e vlefshme jo vetëm në Shqipëri.

REZULTATET E PYETESORIT PER STUDENTIN

Bazuar në përgjigjet e pyetësorit me pyetje të mbyllura dhe të hapura, realizuar me studentët por dhe të dhënave të grumbulluara gjatë fazës studimore; evidentohet nevoja në rritje për shërbime të aksesueshme, sigurta dhe me kosto të ulët nëpërmjet ofrimit të shërbimeve online ndaj studentëve të IAL-ve publike.

Më poshtë po paraqesim rezultatet e këtij pyetësori për këtë rubrikë .

Për pyetjen: ***Ju lutem jepni opinionin tuaj mbi gjendjen e pajisjeve elektronike dhe atyre të IT-së në universitetin/fakultetin tuaj.***

Pjesë e përmirësimit të mësimdhënies në universitete janë dhe pajisjet informatike si PC, Laptop, Tablet, printer, fotokopje etj. Vihet re se universitetet shqiptare nuk janë integruar me shërbimet bashkohore ku disa lëndë kërkojnë vëmendjen e pajisjeve të IT-së të cilat shërbejnë për të mësuar mënyra të ndryshme të të punuarit. Pjesa më e madhe e studentëve mendojnë se pajisjet informatike të disponueshme në

³⁴ Neni 100 “Karta e studentit” Pika 1. I Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë

universitete janë shumë dobët (500) apo dobët (350) dhe një pjesë më e vogël kanë mendim pozitiv rreth pajisjeve të IT-së.

Për pyetjen: *Ju lutem jepni opinionin tuaj mbi gjendjen e pajisjeve elektronike dhe atyre të IT-së në universitetin/fakultetin tuaj*

Duke qenë se në universitetet shqiptare, pajisjet me mjete të IT-së është e ulët ose papërfillshme, vërehet se, mbështetja për përdoruesit si asistencë teknike për pajisje informatike apo disponueshmëria e wireless në Universitete është shumë e dobët (280). Disponueshmëria në internet ka qenë në pjesën më të madhe të rasteve është shumë i dobët (360). Duhet të nxitet një zhvillim më i shpejtë i pajisjeve informatike duke i mbështetur studentët sigurisht edhe në pjesën teknike të këtyre pajisjeve. Gjendja e pajisjeve elektronike në universitetet publike është në të njëjtën tendencë, atë të një gjendje shumë të dobët. Futja e sistemeve të reja të adaptuara me programet e studimeve do t'i ndihmojë studentët në përmirësimin e njohurive në këtë sektor.

Gjetje:

Për sa më lart,

1. Universiteti i Tiranës nuk përdor sistemin informatik prej vitit 2017 për menaxhimin e aktivitetit të mësimdhënies dhe shërbimeve të dixhitalizuar për studentët.
2. Faqet Web zyrtare të IAL-ve subjekt auditimi janë përgjithësisht ilustrative, kanë informacion po jo të strukturuar. Pothuajse të gjitha faqet Web të IAL-ve subjekt në auditim nuk janë të aksesueshme për programin e transparencës si një detyrim ligjor.
3. **Universiteti i Shkodrës konsiderohet “praktik e mirë” në lidhje me komunikimin me e-mail zyrtar me studentet, stafin akademik dhe administrativ.**
4. IAL subjekt auditimi nuk ofrojnë shërbime on line, gjithsesi studentët tërheqin apo shkarkojnë fatura arkëtimi kryesisht në formatin “pdf” nga faqet Web të institucionit.
5. Mungojnë aktet nënligjore për aplikimin kartës së studentit.
6. Nga identifikimi i probatikave nëpërmjet pyetësorit të studentit konstatohet që studentët nuk janë të kënaqur me infrastrukturën elektronike dhe IT-së pranë fakulteteve si suport mbështetës për procesin e mësimdhënies apo të kërkimit shkencor.

Konkluzion:

Për sa më lart,

1. Në Universitetin e Tiranës në njësit kryesore/bazë prej më shumë se dy vitesh stafi akademik i është rikthyer procedurave të mëparshme të hartimit ruajtjes dhe dorëzimit të proces verbaleve të provimeve, etj. Gjithashtu studentët nuk përdorin për shërbimet e tyre **“sekretari elektronike” për zgjedhjen e provimeve sipas lëndëve apo datave të caktuar po shkojnë në sekretarit mësimore.** Kjo ka sjellë rritje të ngarkesës së personelit të sekretarive mësimore pasi ajo menaxhohet nga të njëjtat burime njerëzore. Kjo ka ndikuar në uljen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve ndaj studentëve në këtë institucion.
2. Gjatë navigimit në faqet web të IAL-ve subjekt auditimi vërehet që ato nuk kanë publikuar programin e transparencës sipas përcaktimeve ligjore mbi informimin

dhe transparencën e veprimtarisë së tyre. Ndër problematikat e identifikuar në pyetësor, studentët kërkojnë të informohen *“se ku shkojnë të ardhurat e krijuara nga tarifat e paguara prej tyre”*.

3. Aplikimi i kartës së studentit ngelet një problem që nuk është zgjidhur ende. Mungesa e akteve nënligjore të cilat duhej të propozoheshin nga MASR ka sjell që ky projekt të mos aplikohet për studentët shqiptar. Karta e studentit përbën një nga shërbimet më të nevojshëm dhe të domosdoshëm për studentët.

Rekomandim:

Për sa më lart, grupi i auditimit rekomandon:

1. Universiteti i Tiranës të vendos në funksionim sistemin informatik për menaxhimin e procesit të mësimdhënies dhe shërbimeve dixhitale ndaj studentëve.

Sa më shpejt

2. IAL-të publike subjekte të auditimit duhet të rrisin shërbimet on line për studentet nëpërmjet sistemeve të tyre informatike për pagesat e tarifave të shkollimit dhe për shërbimet e tjera.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

3. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë të përcaktoj kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.

Sa më shpejt

4. IAL-të publike subjekt auditimi të publikojnë programin e transparencës në faqet zyrtare të tyre i cili të jetë i plotë i përditësuar dhe i aksesueshëm.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

Për pyetjen: **A funksionon sistemi feedback-ut në IAL-të publike për përmirësimin e shërbimeve studentore?**

Institucionet e Arsimit të Lartë kanë politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Sigurimi i brendshëm i cilësisë nënkupton një proces të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi, ruajtje dhe përmirësim të cilësisë së veprimtarisë në IAL-të publike, që zhvillohet nga vetë institucioni. Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë, përcaktohet në statutin e IAL-së publike sipas parashikimeve të LAL³⁵. Çdo vit akademik kjo njësi duhet të hartoj pyetësorët³⁶ për studentët mbi bazën e standardeve të kërkuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë³⁷.

³⁵Neni 103

³⁶ Pyetësori për studentet duhet miratohet në senatin akademik

³⁷ VMM nr. 531, date 11.09.2018

Për të sqaruar pozicionin zyrtar të subjekteve në auditim gjatë fazës analitike në lidhje me veprimtarin e strukturave të NJSBC grupi auditues iu drejtua atyre me pyetjen:

A ka Institucioni jua, njësi të sigurimit të brendshëm të cilësisë sipas përcaktimeve në statut? N.q.s. po; A keni raporte mbi sigurimin e cilësisë për vitin akademik 2017-2018? Dhe nëse po; Ju lutem na përcillni Raportin e NJSBC.

IAL-të publike subjekt auditimi; pohuan që struktura të NJSBC janë përgjithësisht pjesë e strukturave të sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë; këto struktura hartojnë dhe përpunojnë përgjigjet e pyetësorit për çdo vit akademik.

Sipas grupit auditues; pyetësorët e hartuar në të shumtën e rasteve nuk gjenerojnë përgjigje të vlefshme për shërbyer si feedback për institucionin. Ndërkohë institucioni nuk analizon dhe përdor rezultatet si **feedback** për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e shërbimeve dhe mësimdhënies ndaj studentëve.

Më poshtë gjeni përmbledhjen e përgjigjeve zyrtare të subjekteve në auditim.

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës; NJSBC funksionon si pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë. Gjatë vitit akademik 2017/18, NJSBC ka hartuar pyetësorin për sigurimin e cilësisë, i cili nuk rezultoi efektiv pasi nuk përmbushte standardet e përcaktuara në kodin e cilësisë së arsimit të lartë. Ky pyetësor u riformulua përsëri nga grupi i punës i ngritur brenda institucionit për tu përshtatur me standardet e kërkuar nga kodi i cilësisë së arsimit të lartë. Rezultatet e përfituara nga pyetësori iu shpërndan dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve. ***Në UAMD nuk ka rregullore specifike për organizimin dhe veprimtarinë e NJSBC.***

NJSBC nuk ka hartuar raportin vjetor të veprimtarisë e vet.

Universiteti Fan S. Noli; NJSBC është e organizuar në rang institucional dhe në njësitë kryesore si pjesë e sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë. Për vitin akademik 2017-2018, NJSBC nuk ka hartuar RVB (Raportin e Vlerësimit të Brendshëm) në shkallë njësie kryesore dhe Institucionale. NJSBC ka në përbërjen e vetë studentë duke e bërë një strukturë më të besueshme në rezultatet dhe në vlerësimin e cilësisë ndaj shërbimeve studentore.

Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër; NJSBC është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë³⁸. NJSBC ka hartuar Draft Raportin për sigurimin e brendshëm të cilësisë i cili pritet të miratohet në mbledhjen e radhës së Senatit Akademik.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka ngritur njësinë e sigurimit të cilësisë³⁹ sipas përcaktimeve të rregullores së funksionimit të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sipas saj kjo NJSBC duhet të hartoj raporte çdo dy vite akademike.

Universiteti bujqësor i Tiranës, ka njësi të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Për vitin akademik 2017-2018 struktura e NJSBC nuk ka hartuar RVB (Raportin e Vlerësimit të Brendshëm) në shkallë njësie kryesore dhe Institucionale.

Universiteti i Tiranës, ka miratuar Statutin e ri në senatin akademik⁴⁰ por nuk ka marrë ende miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në njësitë kryesore nuk janë ngritur dhe nuk funksionojnë strukturat e NJSBC.

Universiteti Ismail Qemali Vlore ka njësi të sigurimit të brendshëm të cilësisë, por nuk ka hartuar raport për sigurimin e cilësisë për vitin akademik 2017/18.

³⁸ Sipas përcaktimeve në Statutin e miratuar Neni 23, Neni 24

³⁹ Vendimi nr.35 date 25.09.2014 "për miratimin e NJSBC per UMT-ne"

⁴⁰ Vendimi I SA nr 30. Date 14.09.2018

PYETËSORI PËR STUDENTET E IAL-VE PUBLIKE

Grupi i auditimit hartoi një pyetësor me pyetje të mbyllura dhe të hapura mbi “Cilësinë dhe tarifimin e shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike”. Nëpërmjet këtij pyetësori grupi i auditimit synon të vjel opinionin e studenteve mbi cilësinë e shërbimeve ndaj tyre. Pyetësori përfshin pyetje në lidhje me efektivitetin e shërbimeve studentore që ofrohen pranë IAL-ve publike

Metodologjia e përdorur:

Pyetësori u publikua online në faqen e Facebook-ut të Departamentit të Auditimit të Performancës pranë KLSH. Si dhe në faqet web të IAL-ve subjekt auditimi, në rrjetet sociale të këshillave studentor të këtyre IAL-ve. Sistemi lejonte plotësimin e pyetësorit vetëm njëherë për çdo pjesëmarrës, element i cili garanton besueshmërinë. Hartimi i pyetësori erdhi si rezultat i kryqëzimit të të dhënave të marra gjatë fazës studimore dhe të terrenit. Pyetësori qëndroi i hapur online rreth 2 javë dhe plotësohej në *google forms* nga studentët që vazhdojnë studimet në IAL-të publike por dhe nga ata që i kanë përfunduar ato brenda 2-3 viteve të fundit.

Pjesëmarrësit kërkoheshin, kryesisht të ishin studentë të IAL-ve publike të mëposhtme:

Universiteti i Tiranës
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Universiteti Bujqësor Tiranë
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Universitete të tjera Publike

Grupi auditues duke marrë parasysh që pyetësori ishte online nuk përjashtoi dhe pjesëmarrës studentë të IAL të tjera publike duke shtuar rubrikën “Universitete të tjera Publike”

Rezultatet e pyetësorit

Në përfundim të këtij pyetësori morën pjesë 1322 studentë ose 1.1% e numrit të përgjithshëm të studenteve në rang vendi⁴¹. Për të parë më qartë problematikat dhe situatën në përgjithësi, është e nevojshme të evidentohen universitetet publike nga ku janë marrë kampionet e përgjigjeve. Universiteti i Tiranës përbën pjesën më të madhe nga ku janë marrë përgjigjet, me 51.1%. Pas tij, me një diferencë të madhe janë, Universiteti i Mjekësisë në Tiranë me 17.1%, Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës me 12% dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër me 7%. Universitetet ku përgjigjet kanë qenë më të pakta janë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë; Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universitetet e tjera publike.

Programi i studimit i cili ndiqet aktualisht ose që është përfunduar 2-3 vitet e fundit nga studentët, ka një rendësi të veçantë në raportimin e saktë të kushteve në të cilat operohet. Programi Bachelor përbën pjesën më të madhe me 61%, më pas renditen programet, Master i shkencave me 23%, dhe Master profesional me 13.5%. Një shkallë të vogël përgjigjesh kanë marrë programet si; programi i integruar i studimit të ciklit të dytë, programi i specializimeve afatgjatë të ciklit të tretë të studimeve, cikli i tretë i studimeve të Doktoraturës dhe program i dytë studimi. Ky marzh i lartë i studentëve në bachelor vjen si pasojë se ky program përbën shkallën e parë të studimeve universitare.

⁴¹ Nr. I përgjithshëm I studenteve është 123,159

Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë

Per pyetjen: *A keni dijeni për ekzistencën e njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë pranë universitetit/fakultetit tuaj?*

Pjesë e njësive përbërëse të universiteteve është edhe njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu dijenia për ekzistencën e kësaj njësie është shumë e vogël me vetëm 13.8% e studentëve, pjesa tjetër nuk e dinë (33.9%) ose nuk kanë asnjë informacion (54.4%). Studentët në përgjithësi nuk kanë dijeni për ekzistencën e njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë pasi nuk ka pasur një promovim të duhur të kësaj njësie dhe përgjithësisht nuk janë pjesë gjate hartimit të pyetësorit për ta.

Per pyetjen: *A keni plotësuar pyetësor për vitin akademik 2017/18 nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë në Fakulteti juaj?*

Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë shpesh herë i drejtohet studentëve nëpërmjet pyetësorëve ku një pjesë e madhe (67.7%) nuk kanë plotësuar asnjë pyetësor për vitin akademik 2017/18 të drejtuar nga kjo njësi dhe një pjesë e vogël rreth 17% kanë realizuar pyetësor. Ky fakt mund të vijë nga mungesa e vëmendjes së studentëve duke neglizhuar plotësimin e pyetësorëve ose nga neglizhenca e vetë njësisë për dërgimin e pyetësorëve studentëve. Pyetësorët e njësisë së sigurimit të brendshme të cilësisë janë në një masë të vogël dhe kjo nuk lejon mundësinë e vlerësimit apo marrjes së masave të nevojshme për të siguruar dhe garantuar cilësinë në universitet. Ky rezultat shkon në përputhje dhe me përgjigjet e mësipërme, pra këto IAL publike nuk kanë një feedback për cilësinë e shërbimeve që iu ofrohet studenteve

KËSHILLAT E STUDENTËVE⁴²

Studentët duhet të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të IAL-së, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. IAL-të publike duhet të mbështesin dhe të financojnë veprimtarin e këshillave të studentëve.

Mbështetur në përgjigjet si gjatë fazës studimore po dhe asaj analitike të IAL-ve publike subjekt në auditim mbi përfaqësimin e studentëve në këshillat e studentëve në Institucion apo njësitë kryesore, pjesëmarrjen e tyre në strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë apo ekzistenca e mekanizmave të tillë që problematikat e tyre të parashtrihen në planet e veprimeve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj tyre përmbledhtazi janë:

UT nuk ka përfaqësi të këshillave studentore në njësitë kryesore dhe në institucion. Veprimtarin e këtyre këshillave e ezurojnë studentë përfaqësues në Senatin Akademik. Gjithashtu dhe Univesiteti i Vlorës është në fazën e zgjedhjeve të këshillave të studentëve.

Sipas grupit auditues; pothuajse të gjitha IAL subjekt auditimi nuk lëshojnë programe studimi në gjuhë të huaj përveç suplimentit të diplomës që jepet në gjuhën shqipe dhe angleze. Njësite kryesore të IAL-ve publike subjekte ne auditim, nuk kanë planifikuar

⁴² Neni 99 I LAL

në PBA respektive shpenzime për mbështetjen e veprimtarisë së këshillave studentor. IAL-të publike mjaftohen vetëm me financimin e aktiviteteve të studenteve, jo të miratuara dhe të planifikuara në rregjistrat e parashikimeve të prokurimeve publike. Per pyetjen: *Sipas perceptimit tuaj; A ka qenë efektiviteti i këshillit/forumit studentor gjatë vitit akademik 2017/18?*

Forumi studentor gjatë një viti akademik është një nga programet e parashikuar nga universitetet publike. Efektiviteti që kanë pasur këto forume referuar përgjigjeve të marra, cilësohet përgjithësisht jo i mjaftueshëm. Specifikisht, alternativa më e zgjedhur është aspak me 23.8% dhe pas saj me shumë pak diferencë është alternativa, pak a shumë me 23.1%. Alternativat shumë pak dhe nuk e di janë më pak të zgjedhura përkatësisht 20.3% dhe 17.9%. Përgjigjeve se efektiviteti ka qenë në një masë të madhe, pra shumë, e përbëjnë pjesa më e vogël me 16%. Duke iu referuar studentëve të pyetur, efektiviteti i forumeve apo aktiviteteve të këshillit është jo i kënaqshëm dhe ky këshill duhet të krijojë një punë organizative më të strukturuar duke shpalosur të gjithë objektivat që synojnë të arrijnë nëpërmjet këtyre forumeve apo aktiviteteve.

Qendra e Karrierës:

IAL-të publike duhet t'iu ofrojnë studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës duhet të mirëpresin studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra/njësia e karrierës duhet të ndjek studentët pas diplomimit të mbledh, përpunoj dhe të mbaj të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe t'ua vëj ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Misioni i Qendrës duhet të mbështesë dhe të inkurajojë studentët dhe Alumnin në zhvillimin e potencialit të tyre për një përjasje më të mirë në tregun e punës, duke rritur kështu numrin e të punësuarve në fushën e tyre të studimit. Ky mision vendoset në jetë, së pari, duke pasuruar eksperiencën studentore, në vijim me punë për t'i përgatitur studentët për kalimin në tregun e punës dhe më pas, duke mundësuar ndërmjetësimin me këtë treg. Për të vlerësuar veprimtarinë e qendrave të karrierës pranë IAL-ve publike, Grupi auditues shtroj pyetjen:

A ka institucioni juaj apo njësitë kryesore qendër të karrierës?

Në vijim pergjigjet e tyre: *Universiteti i Shkodrës* nuk ka qendër të karrierës dhe të këshillimit të studenteve, gjithashtu nuk ka të evidentuar studentët e punësuar mbas përfundimit të studimeve.

Universiteti i Durrësit; qendra e këshillimit dhe alumnit është riorganizuar në sektorin e publikimit, statistikave dhe komunikimit. Ky universitet i jep një rendësi të madhe këshillimit të studenteve dhe gjurmimit të diplomuarve ndër vite duke mbledhur të dhëna për punësim e tyre si dhe organizimin e aktiviteteve studentore. UAMD ka marrë pjesë në dy panairë rajonale të punës në qytetin e Durrësit, në stendën e vet prezantoj;

Informimin e maturanëve për programet e studimit që ofron dhe orientimin drejt tregut të punës. UAMD disponon një bazë të dhënash për ish studentët e punësuar ndër vite, ku jepet informacion mbi pozicionin e punës dhe institucionin ku janë punësuar. Këto të dhëna janë gjeneruar nëpërmjet dërgimit periodik në rrugë

elektronike të "Formularit Alumni" drejt të diplomuarve në UAMD, ku më pas bëhet hedhja e të dhënave mbi punësimin në databazë.

Universiteti i Korçës ka Qendrën e karrierës dhe Alumni. Kjo qendër është aktive dhe ka marrë pjesë në panairë të ndryshme për çdo vit. Ka një prezencë aktive në këto panairë dhe ka organizuar mjaft mirë kërkesat dhe ofrimin për punësim në faqen e vet zyrtare. Gjithashtu ka një bazë të dhënash për të punësuarit ndër vite ish studentë të universitetit. Kjo bazë të dhënash përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka zyrën e komunikimit dhe marrëdhënieve me jashtë që shërben si qendër e karrierës për studentët.

Universiteti Bujqësor ka në nivel institucional Qendrën e karrierës dhe Alumni dhe në njësitë kryesore zyrat e karrierës, të cilat kanë në fokus mbështetjen dhe zhvillimin e karrierës së studentëve. UBT ka një eksperience shumë të mirë në drejtim pasi për të pestin vit organizon panairin e karrierës në UBT me pjesëmarrjen e 40 bizneseve. Qendra e karrierës dhe Alumni kanë përgatitur dhe skedën e punësimit e cila iu vihet në dispozicion studentëve dhe bizneseve. UBT nëpërmjet një projekti të financuar nga donator të huaj ka përgatitur një bazë të dhënash për studentët e diplomuar dhe të punësuar si dhe për gjurmimin e studenteve të diplomuar. Për këtë arsye është themeluar Bordi i Alumni i cili ka në fokus gjurmimin e të diplomuarve në UBT.

Universiteti i Tiranës ka qendër të karrierës në nivel institucional dhe në fakultete duke zhvilluar aktivitete të shumta për promovimin e studenteve në tregun e punës.

Universiteti i Vlorës ka sektorin e këshillimit të studentëve dhe Alumni dhe aktiviteteve studentore si pjesë e drejtorisë së edukimit. Universiteti i Vlorës ka marrë pjesë aktive në panairët e punës dhe gjithashtu ka një bazë të dhënash e cila ka rreth 1500 ish student.

Krahas të dhënave të marra nga përgjigjet zyrtare të IAL-ve grupi auditues gjatë përpunimit të të dhënave të përgjigjeve të pyetësorit për studentë i kryqëzoi ato për të verifikuar gjendjen reale.

QENDRA E KARRIERËS

Për pyetjen: *A keni dijeni për ekzistencën e qendrës së karrierës pranë universitetit / fakultetit tuaj?*

Ekzistenca e qendrës së karrierës pranë universitetit përbën një pyetje jo pak të rëndësishme për ata që i përket informacionit që kanë studentët në lidhje me këtë qendër. Përgjigjet tregojnë që informacioni nuk disponohet nga të gjithë studentët dhe kjo pjesë zë 48.3% të përgjigjeve të marra. Me 52.3% janë përgjigjur se kanë dijeni për ekzistencën e kësaj qendre. Duke qenë se ekzistenca e qendrës së karrierës ka qenë në hije duke mos marrë promovimin e duhur për shërbimin që ofron, ka pasuar me këtë rezultat të paraqitur në grafik. Tendenca për ata që i përket viteve në vazhdim parashikohet të jetë në rritje të vazhdueshme, e mbështetur dhe nga promovimi që e lejon atë të njihet nga studentët.

Për pyetjen: *A keni marrë pjesë në aktivitete të organizuar nga qendra e karrierës për vitin akademik 2017/18 në universitetin/fakultetin ku ju studioni?*

Aktivitetet që kanë zhvilluar qendrat e karrierës përgjatë vitit akademik 2017-2018 nuk kanë patur impaktin e duhur dhe audiencën e plotë pasi në masë dërmuese me 76.6% të pjesëmarrësve janë shprehur që nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në aktivitete të tyre. Në këtë mënyrë kjo përqindje kaq e lartë e mos pjesëmarrjes e aktiviteteve të

qendrës së karrierës tregon që aktivitetet e tyre janë të zbehta dhe pa interes për studentët, ose mungon komunikimi efektiv për promovimin e aktiviteteve të këtyre qendrave.

Për pyetjen: *Ju lutem jepni opinionin tuaj mbi veprimtarinë e qendrës së karrierës në universitetin/fakultetin tuaj?*

Pjesëmarrja në aktivitetet e qendrës së karrierës, Workshop-et dhe trajnimet e zhvilluara nga qendra është vërtetë e ulët. Pjesa më e madhe e studentëve e vlerësojnë pjesëmarrjen e tyre shumë të dobët (300), të dobët (300) dhe mjaftueshëm (290). Pjesa që nuk kishin informacion (270) në lidhje me këto aktivitete është jo e pakët, nga ku mund të vlerësojmë se kjo mangësi vjen nga mungesa e promovimit të duhur të aktiviteteve të qendrës së karrierës. Workshopet e zhvilluara nga qendra kanë qenë shumë dobët (330) ose dobët (290), referuar përgjigjeve të paraqitura në grafik. Në pothuajse të njëjtën situatë paraqiten dhe trajnimet e zhvilluara në bashkëpunim me institucione, organizata apo kompani të ndryshme për të marrë njohuri praktike në fushat përkatëse. Shohim se, një dominancë e konsiderueshme janë përgjigjur me, shumë dobët (330) dhe dobët (290), pa lënë pa përmendur dhe ato që janë përgjigjur me nuk e di (270). Ky grafik, na tregon në mënyrë më të detajuar gjithçka përmendëm në grafikun pararendës (për ekzistencën e qendrës së karrierës) pasi, dhe njëherë faktin mos-njohjen nga studentët nga njëra anë dhe mungesën e punës organizative dhe promovuese të qendrës së karrierës.

Per pyetjen: *Ju lutem jepni opinionin tuaj mbi veprimtarinë e qendrës së karrierës në universitetin/fakultetin tuaj?*

Informacioni i qendrës në lidhje me mundësinë e mobilitetit të studentëve shfaqet midis dy opinioneve më të zgjedhura të cilat janë, shumë dobët dhe dobët. Të shumtë janë dhe mendimet, nuk e di dhe mirë, megjithëse pak të diferencuara nga të parat. Një nga shërbimet ku duhet të jetë një vëmendje të veçantë është dhe informacioni i qendrës në lidhje me përfitimin e bursave të studimit jashtë vendit. Ky informacion, në bazë të grafikut, rezulton të jetë midis opinioneve, shumë i dobët, mjaftueshëm dhe i dobët. Një pjesë e mirë e të të anketuarve janë përgjigjur me nuk e di. Është e rëndësishme të theksojmë se, qendra e karrierës, në bazë të opinioneve të studentëve, ka një mungesë të dukshme të informacionit në lidhje me shumë opsione apo udhëzime të nevojshme për studentët e cilido programi.

Për pyetjen: *A iu ka mundësuar qendra e karrierës praktika apo intership me partnerët e universitetit/njësisë kryesore?*

Një nga qëllimet kryesore të qendrës së karrierës është integrimi i studentëve në tregun e punës nëpërmjet praktikave dhe intership-ve që kjo qendër mundëson me partnerët e universiteteve. Shumica e studentëve (80.2%) nuk kanë zhvilluar asnjë nga praktikat ndërsa 20% kanë realizuar praktikat që kjo qendër mundëson. Siç shihet dhe në grafik praktikat apo intership-et me partnerët e universiteteve, janë pothuajse të papërfillshme në raport me çka duhet të jetë duke marrë parasysh numrin e madh të studentëve.

Për pyetjen: *N.q.s. keni përfunduar studimet 2-3 vitet e fundit; A jeni i punësuar në profilin në të cilin keni kryer studimet?*

Një nga problematikat në vendin tonë është mundësia e punësimit pas përfundimit të studimeve. Kjo është një shifër alarmante sepse 81.7% e studentëve nuk kanë mundur të punojnë në profesionin e tyre 2-3 vitet e fundit ndërsa një shifër shumë e vogël (18.4%) janë punësuar në fushën e tyre brenda 2-3 vitesh. Numri i pakët i studentëve të punësuar 2-3 vite pas përfundimit të studimeve vjen si pasojë e shumë faktorëve, si ajo e mungesës së një tregu që plotëson këtë masë studentësh apo dhe për shkak se universitetet nuk krijojnë bashkëpunimet e duhura me kompani apo institucione për punësimin e këtyre studentëve.

Për pyetjen: *A keni përfituar punësim nëpërmjet kontakteve të krijuara me punëdhënësit nga informimi i qendrës së karrierës ku ju keni kryer studimet?*

Qendrat e karrierës në universitetet shqiptare ndihmojnë fare pak (5.8%) për të krijuar kontaktet e duhura student-punëdhënës për një punësim të mundshëm pas përfundimit të studimeve. 94.2% të cilët nuk kanë përfituar nga qendra gjejnë mënyrë alternative për të siguruar një punë të vlefshme për karrierën e tyre. Grafiku na tregon se studentët që kanë përfituar punësim falë qendrës së karrierës është mjaft i ulët si pasojë e mos-efektivitetit të punës së kësaj qendre.

SHËRBIMET OPERACIONALE NDAJ STUDENTËVE

Për pyetjen: *A janë mbështetës stafet administrative për shërbimet e ndryshme të ofruara gjatë vitit 2017/18?*

Domosdoshmëria e mbështetjes nga stafet administrative për shërbime i takojnë natyrës së vetë këtij sektori, është një pikë e rëndësishme ku duhet të ndalemi. Pak a shumë është përgjigja më e zgjedhur ndër alternativat e tjera të renditura në grafik, me 33.6%. Alternativa shumë pak ka marrë 22.2%, e renditur e dyta përse i përket zgjedhjeve. Shohim që gjejmë një balancë të theksuar në alternativat aspak dhe nuk e di, respektivisht me 16.6% dhe 16.7%. Alternativa më pak e zgjedhur është, shumë me 12.2%, e cila na tregon dhe masën e mbështetjes reale nga këto stafe. Situata e paraqitur tregon se stafet administrative në përgjithësi nuk krijojnë një mbështetje të plotë për shërbimet që ato ofrojnë.

Për pyetjen: *Ju lutem jepni opinionin tuaj mbi cilësinë e sallave të leksioneve/seminareve të disponueshme për mësimdhënie në fakultetin tuaj.*

Është e rëndësishme dhe thelbësore që sallat e leksioneve apo seminareve të disponojnë një standard të pranueshëm dhe të denjë për të krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin mësimor. Niveli i mirëmbajtjes së sallave të leksioneve apo seminareve ka një luhatshmëri midis nivelit të mirë (mbi 300 përgjigje) dhe nivelit shumë të dobët (rreth 280 përgjigje). Më pas përgjigjet më të mëdha i gjejmë te alternativat dobët dhe mjaftueshëm. Numri i vendeve në raport me numrin aktual të studentëve është në një nivel të kënaqshëm dhe kjo reflektohet dhe nga përgjigjet e marra ku pjesa më e madhe varion midis, shumë mirë (300), mjaftueshëm (rreth 280) dhe mirë (250). Padyshim që pasja e një infrastrukturë mbështetëse teknike krijon kushtet për një zhvillim më të plotësuar të një ore mësimore. Kjo pjesë e infrastrukturës nuk është në nivelin e duhur pasi, dhe nga përgjigjet e marra shohim një masë të madhe të zgjedhur të alternativave; dobët (mbi 310) dhe shumë dobët (afërsisht 290). Praktikisht niveli i infrastrukturës në universitetet publike bazuar në përgjigjet e marra kap pothuajse të gjitha nivelet në pothuajse të njëjtën masë përgjigjesh, nga niveli shumë i dobët deri te shumë i mirë. Universitetet që kanë një

infrastrukturë jo në nivelin e duhur duhet të ndërhyjnë për të plotësuar të gjitha standardet minimale për të zhvillimin normal të mësimin.

AFTESIMI ME DIJE PER TREGUN E PUNES

Universitetet në mbarë botën janë institucioni i fitimit të dijes dhe aftësive që e bëjnë studentin e gatshëm për tregun e punës.

Për pyetjen: ***Në përgjithësi, sa i/e kënaqur jeni me njohuritë/aftësitë e fituara gjatë programit tuaj të studimit?***

Në Shqipëri vihet re se shumica e studentëve nuk janë shumë të bindur me njohuritë që ato kanë marrë përgjatë viteve të studimit. 48% janë pak a shumë të kënaqur, ndërsa 25.5% janë shumë të kënaqur me aftësitë e fituara gjatë programit, 18.4% mendojnë që nuk kanë fituar asgjë gjatë studimeve.

Për pyetjen: ***Për aq sa mund të arsyetoni tani; A besoni se arsimimi juaj, iu ka përgatitur për tregun e punës?***

Integrimi i shpejtë në punë është një tjetër problem që universitetet duhet të punojnë fort ku lipset shtimi i praktikave gjatë studimeve, zhvillimi i qendrës së karrierës për të ardhur në ndihmë studentëve, përmirësimi i shërbimeve operationale etj. Shumica mendojnë se janë pak a shumë të përgatitur për tregun e punës (39.6%) dhe përqindjen tjetër më të madhe e zënë studentët shumë pak të përgatitur për punë (28.7%). Anketimi i studentëve në lidhje me përgatitjen që i ka ofruar arsimimi në universitet për tregun e punës, tregon se shumë pak besojnë se kanë marrë aftësitë e duhura për të hyrë në treg të sigurt gjë që tregon se universitetet duhet të ofrojnë më shumë integrim me praktika në programet e tyre.

Për pyetjen: ***Ju lutem jepni opinionin tuaj mbi nivelin e informimit dhe komunikimit të stafit akademik me studentët.***

Niveli i informimit dhe komunikimit të stafit akademik me studentët, vlerësohet në bazë të disa faktorëve të cilat janë të rëndësishme në mbarëvajtjen e plotë të të gjitha proceseve informuese. Komunikimi midis studentit dhe stafit akademik bën pjesë te faktorët kryesorë i cili duhet të funksionojë. Niveli i këtij komunikimi, në bazë të përgjigjeve të marra, rezulton të jetë, mjaftueshëm (mbi 350) dhe mirë (rreth 330). Angazhimi i stafit akademik mbi informimin dhe sugjerimet për studentët, referuar përgjigjeve, ka një përafërsi midis të gjitha alternativave, ku më e zgjedhura është mjaftueshëm (afërsisht 270). Gatishmëria e stafit akademik mbi informimin e studentëve është një tjetër faktor që ndikon në nivelin në përgjithësi. Alternativa mjaftueshëm ka marrë përgjigjet më të shumta (me 330), pas saj renditen si më të zgjedhura alternativat,; shumë mirë (rreth 300) dhe mirë (270). Niveli informimit dhe komunikimit të stafit akademik me studentët në terma të përgjithshëm ka një raport pozitiv duke ndihmuar studentë të kenë një mbështetje në fushat ku ata (studentët) marrin njohuri.

INDENTIFIKIMI I PROBLEMATIKAVE NGA PYTESORI

Krahas pyetjeve të mbyllura pyetëtori përmbante dhe pyetje të hapura

Sugjerimet e pjesëmarrësve konsistojnë në evidentimin dhe kërkesa për përmirësim të infrastrukturës së sallave por dhe tek mungesa e komunikimit sidomos me

sekretaritë mësimore, në mënyrë të përmbledhur më poshtë gjenden sugjerimet kryesore.⁴³

- Të përmirësohet infrastruktura (ndriçimi, sallat e leksioneve, ngrohja etj.)
- Komunikimi sa më i ngrohtë ndaj studentëve . Metodologji të ndryshme , dhe dhënia e rezultateve sipas meritave.
- Studentët të informohen rreth pjesës së tarifës së studimit se ku shkon ajo?
- Çfarë përmirësimesh kanë ndodhur në fakultetin ku unë studioj nga këto tarifa që ne paguajmë?
- Ulje të tarifës së studimit pasi paguajmë një tarifë shumë të lartë krahasuar me mundësitë ekonomike dhe njohurit që marrim .
- Unë jam duke ndjekur studimet në nivel master dhe pothuajse të gjitha lëndët janë përsëritje e atyre që kemi zhvilluar në bachelor pra mbetemi vetëm në nivelin teorik dhe kjo gjë nuk na përgatit siç duhet për tregun e punës.
- Sugjerimi im do të ishte të ketë më shume efektivitet dhe transparence në përdorimin e fondeve.
- Më shumë informacion nga qendra e karrierës.
- Më shume informacion rreth bursave apo praktikave. Rregullimi i infrastrukturës së sallave
- Në Universitetin e Tiranës prej dy vitesh mungon sistemi në të cilin hidheshin notat e provimeve duke e bërë shumë të vështirë informimin mbi notat
- Mendoj se përmirësimi duhet të filloj nga sekretaret, të cilat me mungesën e hapur të komunikimit që shfaqin e tregojnë qartë se ku fillon defekti në fakultetet publike.
- Duhet të jenë më shumë salla leksionesh që të evitohet mësimi mbas ditë
- Duhet të funksionoi këshilli studentor
- Ofrim i punës me kohë të pjesshme për studentë nga universitetet dhe angazhimi i tyre si p.sh. në sekretar, bibliotekat etj.
- Gjithashtu do të sugjeroja që të zhvilloheshin më shumë orë praktike sesa teorike.
- Përmirësim i infrastrukturës, ripërzgjidhje e literaturës pasi pjesa më e madhe janë libra të pedagoqeve, saqë ndodh që për të njëjtën lëndë, brenda të njëjtës degë përdoren dy libra të ndryshëm në varësi të pedagoges që jep mësim, pasi secila përdor librin e vet
- Vendosja e portalit studentor onLine; Reduktimi i procedurave burokratike për marrjen e vërtetimeve studentore; Portali mund të funksionojë si e-albania
- Etj.

Konkluzione:

Për sa më lart:

1. Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit është një indikator teje i rëndësishëm për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga IAL-të. Të gjitha IAL-të subjekt auditimi kanë NJSBC, por ato nuk janë efektive gjatë veprimtarisë së tyre dhe nuk kanë përcaktime të detajuara në rregullore të veçanta, në rregulloren e brendshme institucionale apo të njësive kryesore.
2. NJSBC nuk përdorin metodologji sipas standardeve të kërkuara në kodin e cilësisë

⁴³ Shenim: Grupi I klsh ka bere vetem regullime ortografike dhe ne asnje rast nuk ka prekur permbajtjen e pergjigjeve

së arsimit të lartë. NJSBC nuk i hartojnë pyetësorët sipas standardeve të kodit të cilësisë. Si rrjedhim rezultatet e marra nga pyetësorët nuk kanë sjell feedback-un e vërtet. Raportet e NJSBC të disa IAL-ve publike nuk orientojnë problemet dhe të projektojnë plan veprimet për zgjidhjen e tyre por janë përshkruese dhe pa objektiva.

3. Financimi i aktivitetet të këshillave studentor bëhet sporadik dhe jo i planifikuar në PBA dhe regjistrat e prokurimeve publike. Mjth-se LAL parashikon mbështetje financiare për veprimtarit e këshillit studentor; IAL-të nuk bëjnë planifikime për kërkesat e tyre në parashikimet për shpenzimet vjetore
4. Qendrat e karrierës duhet të jenë aktive dhe të kenë marrëdhënie bashkëpunimi si me tregun publik dhe atë privat nëpërmjet marrëveshjeve të shkruar dhe sidomos në përzgjedhjen e temave për doktoraturë, të cilat të kenë impakt direkt në tregun e punës apo të partnereve të saj.
5. Raportet e vlerësimit të NJSBC duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.
6. IAL-te duhet të publikoj rezultatet e pyetësorëve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale
7. Institucioni duhet të organizoi veprimtari periodike me studentët për informimin sigurimin e cilësisë së shërbimeve studentore.
8. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. IAL-te publike duhet te synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit
9. Gjithnjë e më shumë duhet që IAL-të të bashkëpunojnë me partnerë socialë të ndryshëm, si p.sh nga sektori privat dhe DAP -in, para përfundimit të studimeve duke krijuar një databasë për studentët që në fund vitit të dytë “Bachelor” dhe fund të vitit parë të programeve “Master” për të mundësuar informacionin e duhur për mundësit e punësimit për studentët e shkëlqyer.

Rekomandime

Për sa më lart, grupi i auditimit rekomandon:

1. IAL-të subjekt auditimi duhet të hartojnë rregullore të veçantë për Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Brenda 6 mujorit të parë 2019

2. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë duhet hartoj për çdo vit akademik raportin e vlerësimit të brendshëm sipas standardeve të parashikuara në kodin e cilësisë së arsimit të lartë duke e reflektuar në rregulloren e vet të NJSBC

Në vijimësi dhe vazhdimisht

3. IAL-te publike subjekt i këtij auditimi duhet të hartojnë raportin për vlerësimin e brendshëm sipas standardeve të parashikuara në kodin e cilësisë së arsimit të lartë për çdo vit akademik nga institucioni dhe njësisë kryesore.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

4. IAL-të Publike subjekt auditimi duhet të planifikojnë në PBA respektive fonde për financimin e aktiviteteve të këshillave të studenteve sipas kërkesave të tyre miratuara në Institucion/Njësitë kryesore.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

5. Qendra/Zyra e karrierës duhet të intensifikojnë aktivitetin e tyre përmes rritjes së informimit për intership dhe mundësi punësimi, organizimi të workshop-ve dhe informimin për mundësit për mobiliteti dhe bursave jashtë.

Në vijimësi dhe vazhdimisht

6. Qendrat e karrierës duhet të organizojnë panire të punës/karrierës të cilat të shërbejnë si burim informacioni për mundësi realizimi praktikash mësimore, punësimi, bursash dhe trajnime

Në vijimësi dhe vazhdimisht

7. Universiteti i Tiranës dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të ngrejnë Këshillat Studentor.

Sa më shpejt

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Grupi i Auditimit

Rinald Muca
Alfred Leskaj
Silvana Ramadani

Bujar LESKAJ

KRYETAR

